



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 541/3 Prot.

Tiranë, më 20.07.2018

VENDIM

Nr.73, datë 20.07.2018

“Mbi verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë në zhvillimin e procedimit disiplinor ndaj nëpunësit ***”**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit dhe materialit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit paraprak të informacionit të marrë nga kërkesa e nëpunësit *****,

VËREJ SE

Nëpërmjet kërkesës së regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 541 prot., datë 25.06.2018, kërkuesi ***** ka ngritur pretendimin se procedimi disiplinor i filluar ndaj tij, nuk është zhvilluar në përputhje me kërkesat ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe në Vendimin nr. 115, datë 05.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen dhe vendimmarrjen e Komisionit Disiplinor në shërbimin civil”.

Nga verifikimi administrativ i kryer nga Komisioneri, rezulton se , punonjësi ***** me aktin nr. 1606/48, datë 30.10.2014, të Departamentit të Administratës Publike, është deklaruar “Nëpunës civil”, në pozicionin “Zv Drejtor Ekzekutiv/Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit të Cilësisë dhe Sistemimit të Menaxhimit të Sigurisë”. Më pas, si rrjedhojë e implementimit të strukturës së re organizative, miratuar me vendimin nr. 79, datë 21.12.2017, të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Aviacionit Civil, Departamenti i

Administratës Publike, në referencë të propozimit të Komisionit të Ristrukturimit, ka vendosur transferimin e përhershëm të nëpunësit ***** në pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Operatorëve Ajrorë dhe Organizatave të Mirëmbajtjes, në Autoritetin e Aviacionit Civil.

Rezulton se, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të ushtrimit të kompetencave ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014, *“Për organizimin dhe funksionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*, ka realizuar kontroll në subjektin Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC), me objekt *“Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimitarisë ekonomiko-financiare”*, për periudhën e veprimitarisë nga data 01.01.2016 deri më datën 31.12.2017.

Në zbatim të nenit 58, germa ç, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, Kontrolli i Lartë Shtetit, pas evidentimit të shkeljeve të konstatuara prej tij në raportin përfundimtar të auditimit, ka kërkuar prej Komisionit Disiplinor të AAC, fillimin e procedurës për dhënien e masës disiplinore *“Largim nga shërbimi civil”*, për nëpunësin ***** me detyrë Zv. Drejtor Ekzekutiv, për periudhën objekt auditimi.

Në përmbajtje të këtij raporti auditimi rezulton se, ecuria disiplinore ndaj nëpunësit në fjalë, është kërkuar me pretendimin e shkeljes së dispozitave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, *“Për prokurimin publik”*, me qëllim të përfitimit financiar, në realizimin e procedurës së prokurimit me objekt: *“Eventi në lidhje me Fushatën Publicitare për sensibilizimin e opinionit publik në lidhje me të drejtat e pasagjerëve dhe detyrimet e tyre (blerje posterash, fletëpalosje, hostes etj.) dhe aplikacioni”*.

Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka konsideruar shkeljet e mësipërme, si moszbatim të dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale dhe përfitim në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë të përfitimeve financiare, veprime, të cilat bazuar në nenin 57, pika 2, germa “c” dhe “d”, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, klasifikohen si shkelje shumë të rënda disiplinore dhe në kuptim të nenit 59, pika 2, të ligjit në fjalë, organi kompetent për shqyrtimin e tyre është Komisioni Disiplinor.

Në zbatim të dispozitave të mësipërme, titullari i institucionit, me marrjen dijëni të shkeljeve të konstatuara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, me urdhrin e brendshëm nr. 207, datë 04.06.2017, ka ngritur Komisionin Disiplinor, më përbërje si më poshtë:

- *****; Drejtor në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Infrastrukturës dhe Territorit, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës – Kryetar, në cilësinë e një nga nëpunësit më të lartë në MIE (*caktuar me shkresën nr. 8168/1 prot., datë 04.06.2018, “Kthim përgjigje”, të Sekretarit të Përgjithshëm të MIE*);

- ******, Drejtor Ekzekutiv i Autoritetit të Aviacionit Civil – anëtar, në cilësinë e eprorit direkt;
- ******, Specialist në Drejtorinë e Shërbimeve të Përgjithshme në AAC – anëtar, në cilësinë e përfaqësuesit të njësisë së burimeve njerëzore;
- ******, Inspektor në Drejtorinë e Mbikëqyrjes së Operatorëve Ajror dhe Organizatave të Mirëmbajtjes – anëtar, në cilësinë e nëpunësit më të vjetër civil në Autoritetin e Aviacionit Civil;
- ****** – anëtar, në cilësinë e përfaqësuesit të njësisë përgjegjëse, departamentit të Administratës Publike (*caktuar me autorizimin nr. 4191/1 prot., datë 14.06.2018*).

Për nisjen e ecurisë disiplinore, Komisioni Disiplinor, me shkresën 1054/5 prot., datë 05.06.2018, ka njoftuar nëpunësin të cilit i atribuohet shkelja, me qëllim për t'i garantuar të drejtat e përcaktuara në nenin 59, pika 7, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, siç janë e drejta e nëpunësit për t'u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit, për t'u informuar lidhur me shkeljen faktike të pretenduar dhe provat për kryerjen e saj, e drejta për t'u dëgjuar, për të paraqitur prova, për mbrojtje juridike dhe e drejta për t'u asistuar nga një avokat apo një përfaqësues ligjor. Seanca disiplinore për shqyrtimin e shkeljes së pretenduar ndaj nëpunësit ******, është zhvilluar në datën 18.06.2018 (*pas një shtyrje të ligjshme, datë 14.06.2018*), brenda ambjenteve të Autoritetit të Aviacionit Civil.

Në këtë seancë, Sekretariati Teknik, i ngritur për të asistuar Komisionin Disiplinor, ka mbajtur procesverbalin nr. 1110/1 prot., datë 18.06.2018, nga përmbajtja e të cilit rezultojnë se në seancë kanë qenë të pranishëm të 5 anëtarët e Komisionit Disiplinor si dhe nëpunësi ******. Në këtë seancë disiplinore, nëpunësi në fjalë, ka pretenduar duke arsyetuar sipas tij, se shkeljet e konstatuara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në procedurat e prokurimit të realizuara për periudhën 01.01.2016 – 31.12.2017, nuk janë pasojë e mospërmbushjes së detyrave funksionale të pozicionit si Zv.Drejtor Ekzekutiv/*Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit të Cilësisë dhe Sistemimit të Menaxhimit të Sigurisë*, në të cilin ky nëpunës ka qenë i emëruar për periudhën objekt auditimi.

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se, Komisioni Disiplinor, në mbledhjen e datës 18.06.2018, gjatë shqyrtimit të shkeljeve të pretenduara ndaj nëpunësit ******, ka vendosur pezullimin nga ushtrimi i detyrës për këtë nëpunës, deri në përfundim të procedimit administrativ disiplinor (*vendimmarrje e cila materializohet në vendimin e ndërmjetëm nr. 1110/2 prot., datë 18.06.2018*). Nga përmbajtja e këtij akti administrativ, konstatohet se Komisioni Disiplinor, nuk e ka arsyetuar vendimin duke mos parashtruar arsyet dhe shkaqet ligjore të cilat përlligjin këtë vendimmarrje, siç kërkohet prej nenit 59, pika 6, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar.

Njëkohësisht, nga përmbajtja e procesverbalit të seancës disiplinore të zhvilluar në datën 18.06.2018, rezulton se, Komisioni Disiplinor nisur nga fakti se Kontrolli i Lartë i

Shtetit ka depozituar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë kallëzimin penal nr.1312/26, datë 15.05.2018, ndaj shtetasit *****, në zbatim të nenit 66, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me vendimin nr. 1110/3 prot., datë 18.06.2018, ka vendosur pezullimin e procedimit disiplinor, deri në shqyrtimin e çështjes penale në ngarkim të këtij nëpunësi.

Në lidhje me këtë fakt, nëpunësi ***** ka pretenduar, se vendimi i Komisionit Disiplinor nuk është i bazuar në prova dhe dokumente shkresore, për faktin se, gjatë zhvillimit të seancës disiplinor nuk është administruar asnjë provë që të vërtetojë ekzistencën e një procedimi penal në ngarkim të tij, apo vënien e tij përpara përgjegjësisë penale. Nga ana tjetër, në referencë të dokumentacionit të sjellë prej ankuesit (*konkretisht, vërtetimit të datës 22.06.2018, lëshuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë*), nuk rezulton që pranë këtij institucioni të ketë nisur një procedim penal në ngarkim të këtij nëpunësi.

Në lidhje me rastin konkret, në vlerësim të rrethanave si dhe dokumentacionit të administruar në kuadër të hetimit administrativ, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit civil, vlerëson se veprimet administrative të kryera prej Komisionit Disiplinor, në kuadër të zhvillimit të ecurisë disiplinore ndaj nëpunësit *****, vijnë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil” dhe të Udhëzimit nr. 1, datë 02.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, “Për elementët kryesorë proceduralë dhe materialë të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”.

Në rastin konkret, rezulton se, shkeljet disiplinore të konstatuara në raportin përfundimtar të auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, në ngarkim të nëpunësit *****, janë klasifikuar si shkelje shumë të rënda disiplinore. Në këto kushte, në zbatim të nenit 59, pika 2, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, organi disiplinor për shqyrtimin e shkeljeve të kësaj natyre është Komisioni Disiplinor. Ky organ administrativ ndërtohet dhe funksion në bazë të të Vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil”, i cili përcakton në mënyrë të detajuar përbërjen e Komisionit Disiplinor si dhe procedurën konkrete që duhet të zbatohet për shqyrtimin e shkeljes nga ana e tij.

Konkretisht në Kreun I, pika 2, të këtij akti nënligjor, përcaktohet se, Komisioni Disiplinor për institucionet e administratës shtetërore përbëhet nga 5 anëtarë dhe ka përbërjen e mëposhtme:

- a) nëpunësin më të lartë civil të institucionit ku punon nëpunësi për të cilën ka nisur ecuria disiplinore, i cili kryeson komisionin;
- b) eprorin direkt të nëpunësit civil, për të cilin ka nisur ecuria disiplinore;
- c) drejtuesin e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit ku bën pjesë nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore;
- d) një përfaqësues të Departamentit të Administratës Publike;
- e) nëpunësin më të vjetër civil të institucionit ku punon nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore.

Nisur nga sa më sipër, si dhe në referencë të dokumentacionit të administruar, konstatohet se, në rastin konkret, përbërja e Komisionit Disiplinor është e parregullt, pasi rezulton se, kryetari i këtij komisioni, *****, me detyrë “Drejtor në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Infrastrukturës dhe Territorit, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës” i cili është emëruar dhe ka marrë pjesë në shqyrtimin e ecurisë disiplinore, në cilësinë e nëpunësit më të lartë civil të institucionit të Autoritetit të Aviacionit Civil, nuk përmbush kushtet e parashikuara në dispozitën e sipërcituar, duke sjellë në këtë mënyrë një gjendje paligjshmërie në funksionimin e komisionit.

Vlerësohet se kjo paligjshmëri ka ardhur si rrjedhojë e interpretimit dhe zbatimit jo të drejtë të legjislacionit të posaçëm për shërbimin civil, në lidhje me përcaktimin e nëpunësit më të lartë civil të institucionit, i cili duhet të drejtojë Komisionin Disiplinor.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në kuadër të trajtimit të rastit konkret, konstaton faktin se, institucioni i Autoritetit të Aviacionit Civil, ushtron kompetencat dhe funksionet e tij mbi bazën e ligjit nr. 10233, datë 11.02.2010, “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, ku në nenin 3 të tij, përcaktohet se, ky institucion është në varësi të ministrisë që mbulon çështjet e transportit, që në rastin konkret është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës. Nisur nga kjo, në kuptim të vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, pozicioni i Sekretarit të Përgjithshëm përbën nëpunësin më të lartë civil në ministri.

Nisur nga veçoria e rastit konkret, për shkak të mënyrës së klasifikimit të pozicioneve të shërbimit civil si dhe në analizë të strukturës organizative të institucionit të Autoritetit të Aviacionit Civil dhe të linjës hierarkike, konstatohet se në rastin e nëpunësit *****, i cili mbante pozicionin “Drejtor Drejtorie”, me cilësinë e nëpunësit më të lartë civil të institucionit paraqitet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikës.

Nga ana tjetër, Komisioneri vlerëson se, paligjshmëria nëpërbërjen e Komisionit Disiplinor, ka ardhur dhe si rrjedhim i mosrespektimit të procedurës të përcaktuar në Kreun

I, pika 6, të vendimit nr.115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil”, në të cilin përcaktohet se:

“..Në rast të lindjes së nevojës së zëvendësimit të anëtarëve të KD-së, për arsye të pamundësisë apo pengesës ligjore, zbatohen dispozitat për zëvendësimin, të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative”.

Në të njëjtën kohë, konstatohet se, në mënyrën e krijimit të Komisionit Disiplinor, nuk janë mbajtur parasysh përcaktimet e Kreut B/3, të Udhëzimit nr. 1, datë 02.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike “Për elementët kryesorë proceduralë dhe materialë të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”, në të cilin janë përcaktuar në mënyrë të detajuar procedura e zëvendësimit, si dhe lidhja hierarkike midis zëvendësuesit dhe të zëvendësuarit. Sipas përcaktimeve të këtij kreu, rezulton se zëvendësimi bëhet nga personi që mbulon pozicionin e parë të punës në hierarki, pas anëtarit të Komisionit të Disiplinës që do të zëvendësohet, mundësisht në përputhje me linjën profesionale të nëpunësit, subjekt i procedimit disiplinor.

Referuar përcaktimeve të dispozitës së mësipërme, vlerësohet se, në pozicionin e Kryetarit të Komisionit Disiplinor në rastin konkret, duhet të ishte caktuar nëpunësi civil, i cili në linjë hierarkike vjen direkt pas pozicionit të Sekretarit të Përgjithshëm. Në analizë të strukturës organizative të ministrisë, rezulton se në cilësinë e anëtarit zëvendësues për Sekretarin e Përgjithshëm, duhet të ishte caktuar një nëpunës civil, i cili mbante pozicionin “Drejtor i Përgjithshëm” dhe jo “Drejtor Drejtorie” siç është vepruar në rastin konkret.

Nga ana tjetër, konstatohet se, akti nr. 8168/1 prot., datë 04.06.2018, i Sekretarit të Përgjithshëm, për caktimin e Kryetarit të Komisionit Disiplinor, për këtë rast nuk arsyetohet dhe nuk parashtron shkaqet e ligjshme, të cilat pengojnë pjesëmarrjen e Sekretarit të Përgjithshëm në këtë komision.

Për më tepër, duke trajtuar dhe vlerësuar ligjshmërinë e veprimeve administrative të Komisionit Disiplinor, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, konstaton elementë të paligjshmërisë në drejtim të respektimit të kërkesave të formës së akteve administrative të derivuara nga ky procedim disiplinor.

Nëni 100, i ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, përcakton se, akti administrativ duhet të jetë i qartë dhe ndër të tjera duhet të përmbajë:

- a) shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë akti;
- b) shpjegimin e përmbledhur të rezultatit të hetimit administrativ dhe të vlerësimit të provave

c) bazën ligjore të aktit dhe një shpjegim pse kushtet ligjore për zbatimin e tij, plotësohen në këtë rast.

Nisur nga kjo kerkëse e ligjit, vlerësohet se, vendimi i ndërmjetëm i Komisionit Disiplinor, me nr. 1110/2, datë 18.06.2018, me të cilin është vendosur pezullimi nga ushtrimi i detyrës të nëpunësit *****, për periudhën deri në përfundim të procesit administrativ disiplinor, është i paarsyetuar dhe i paargumentuar, gjë që e bën aktin të paligjshëm.

Detyrimi ligjor për arsyetimin e qartë të një akti administrativ, përcaktohet shprehimit dhe në përmbajtje të nenit 59, pika 6, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në të cilin përcaktohet se: “Nëse ka arsye të besohet se vazhdimi i ushtrimit të detyrës nga nëpunësi civil, ndaj të cilit ka filluar një procedim disiplinor, pengon hetimin administrativ apo mund të cenojë ushtrimin e përshtatshëm të detyrës së tij, Komisioni Disiplinor vendosi pezullimin e nëpunësit civil, deri në marrjen e vendimit përfundimtar”.

Për sa më sipër, konkludohet se, Komisioni Disiplinor, duhet të kishte analizuar dhe parashtruar arsyet dhe rrethanat konkrete, të cilat kanë krijuar bindjen se vazhdimi i ushtrimit të detyrës nga punonjësi *****, do të pengonte vijueshmërinë në normalitet të hetimit administrativ apo do të cenonte ushtrimin e përshtatshëm të detyrës së tij.

Në referencë të dokumentacionit të administruar, Komisioneri konstaton se elementët e formës së aktit administrativ evidentohen në të njëjtën kohë edhe nëvendimin e ndërmjetëm nr. 1110/3, datë 18.06.2018, të Komisionit Disiplinor, me të cilin është vendosur pezullimi i procedimit disiplinor të nisur ndaj nëpunësit *****, deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake (duke mos u shprehur konkretisht së për cilën çështje është marrë një vendim i tillë), pa parashtruar faktet dhe pa analizuar ndonjë provë shkresore, të cilat përlligjin pezullimin e procedimit disiplinor.

Fakti se nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit është depozituar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë kallëzimi penal me nr. 1312/26, datë 15.05.2018, në emër të nëpunësit *****, pa e shoqëruar me dokumentacion se ka filluar një procedim penal, apo personi është vënë nën hetim, nuk mund të merret në konsideratë për të justifikuar pezullimin e procedimit disiplinor. Për më tepër, rezulton se, ankuesi, disponon një vërtetim të datës 22.06.2018, i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të cilin vërtetohet se, nuk ka asnjë procedim penal të regjistruar në emër të nëpunësit *****.

Si përfundim, për të gjitha arsyet që janë analizuar sa më sipër, arrihet në përfundimin se, vendimi nr. 1110/2, prot., datë 18.06.2018, i Komisionit Disiplinor, për pezullimin nga ushtrimi i detyrës i nëpunësit ***** dhe vendimi nr. 1110/3 prot., datë 18.06.2018, i Komisionit Disiplinor, për pezullimin e procedimit disiplinor, janë akte të të cilat në kuptim

të nenit 109, pika “b”, “c” dhe “d” të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, përbëjnë akte administrative të paligjshme, e për këtë arsye në referencë të nenit 114, pika 1, të po këtij ligji, këto akte duhet të shqufizohen.

Në vijim të këtij arsyetimi, Komisioni Disiplinor, i ngritur me urdhrin nr. 207, datë 04.06.2018, të Drejtorit Ekzekutiv, për shqyrtimin e shkeljes disiplinore të pretenduar ndaj nëpunësit *****, në zbatim të nenit 14, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, duhet të shfuqizojë vendimet 1110/2 prot., datë 18.06.2018 dhe nr. 1110/3 prot., datë 18.06.2018.

Në vijim të këtij veprimi administrativ, Drejtori Ekzekutiv i Autoritetit të Aviacionit Civil, duhet të shfuqizojë pjesërisht urdhrin nr. 207, datë 04.06.2017, duke rregulluar përbërjen e Komisionit Disiplinor, në përputhje me përcaktimet e Kreut I, piks 2, të vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil*”, si dhe Udhëzimit nr. 1, datë 02.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, “*Për elementët kryesorë proceduralë dhe materialë të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore*”.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, si dhe në nenet 16, 34 dhe 35, të Rregullores, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të kërkojë nga Drejtori Ekzekutiv i Autoritetit të Aviacionit Civil, të shfuqizojë pjesërisht urdhrin nr. 207, datë 04.06.2018, në pjesën ku “*****, me detyrë në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Infrastrukturës dhe Territorit në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës”, caktohet Kryetar i Komisionit Disiplinor, në cilësinë e përfaqësuesit të MIE, si një akt i dalë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.
2. Drejtori Ekzekutiv i Autoritetit të Aviacionit Civil, duhet të marrë masa për ringritjen e Komisionit Disiplinor, në përputhje me kërkesat e Kreut I, pika 2, të vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil*” dhe të respektimit të procedurës së zëvendësimit të anëtarëve të KD,

sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 1, datë 02.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, “Për elementët kryesorë proceduralë dhe materialë të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”, duke respektuar elementët hierarkikë që kërkohen prej akteve të mësipërme, për të siguruar raportin e niveleve administrative, ndërmjet nëpunësit të proceduar dhe proceduesit.

3. Komisioni Disiplinor, i ngritur për shqyrtimin e shkeljes së pretenduar ndaj nëpunësit ***** , për rregullimin e paligjshmërisë së procedurës disiplinore të kryejë veprimet përkatëse ligjore, për shfuqizimin e vendimit nr. 1110/2 prot., datë 18.06.2018 dhe vendimin nr. 1110/3 prot., datë 18.06.2018, si akte administrative të paligjshme dhe vetëm pas kësaj mund të fillojë shqyrtimin e procedimit disiplinor.
4. Komisioni Disiplinor, duhet të tregojë kujdes për respektimin e dispozitave ligjoretë cilat rregullojnë institutin e ecurisë disiplinore, me qëllim garantimin e të drejtave të nëpunësit civil, nëpërmjet zhvillimit të një hetimi administrativ të bazuar në ligj dhe në prova, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.
5. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 15 ditë, nga marrja dijeni për këtë vendim.
6. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse është e detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
7. Në rast të mos respektimit të këtij vendimi, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve, që nuk kanë kryer detyrimet e lëna në këtë vendim dhe në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
8. Të njoftohet për këtë vendim, Autoriteti i Aviacionit Civil, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës, Departamenti Administratës Publike dhe nëpunësi *****.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha